VENDIM
Nr. 228, datë 28.10.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SLR ALBANIA" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/1 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'LR Albania' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "SLR Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2152 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "c"; për pikën 2.1, germat "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "SLR Albania" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 114 rep., nr. 73 kol., datë 31.1.2024, "Për ndërtimin, shfrytëzimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqërisë 'SLR Albania' sh.p.k.".

- Ka marrë miratimin e pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nr. 5972/3 prot., datë 27.7.2022.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 28.7.2022 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i impiantit fotovoltaik 2 mw, Topojë, Fier", për shoqërinë "SLR Albania" sh.p.k. Kjo VNM ka qenë e vlefshme deri më datë 28.7.2024, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë që ka filluar punimet e ndërtimit të centralit fotovoltaik brenda kësaj date, ose duhet të depozitojë një VNM të re.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa "b":** aplikuesi duhet të depozitojë të përditësuar vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë, i cili është lëshuar më datë 16.10.2024, më herët se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit të

shoqërisë në ERE dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, pikës 3 të rregullores, vlerësohet që t'i kërkohet shoqërisë që të depozitojë vërtetimin për gjendjen gjyqësore për shoqërinë të përditësuar.

- **germa "c":** struktura organizative duhet të depozitohet e nënshkruar dhe/ose vulosur.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "a":** aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shëndetësore, ndaj për plotësimin e kërkesave të kësaj pike të rregullores, subjekti duhet të depozitojë në ERE veçmas vërtetimin që nuk ka asnjë detyrim në lidhje shlyerjen e këtyre detyrimeve ose periudhën që i korrespondojnë detyrimet sipas përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.

- **germa "b":** aplikuesi duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë për vënien në dispozicion të fondeve të saja për realizimin e projektit. Shoqëria ka dokumentuar se do ta financojë projektin përkatësisht në vlerën 80% me kredi bankare dhe 20% me fonde të veta, si dhe ka dokumentuar vlerën përkatëse për realizimin e vlerës totale të projektit, por në lidhje me financimin nga fondet e veta, ka depozituar vetëm konfirmimin e llogarisë, për këtë arsye kërkohet që shoqëria të depozitojë dhe vendimin e organeve drejtuese të saj për dedikimin e vlerës monetare të saj të vënë në dispozicion të zhvillimit të projektit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

- **germa "a":** aplikuesi duhet të bëjë saktësimin e njësive gjeneruese, pasi rezulton se kapaciteti total tejkalon kapacitetin e përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe lejet që ka marrë shoqëria.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SLR Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovotlaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë "SLR Albania" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti